



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.09.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2519-15 për znj. Shpresa Miftari – Auditore e Performancës në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), për shkak se është parandaluar konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë znj. Miftari ka dhënë dorëheqje nga funksioni i saj publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2519-15, për Zyrtares e lartë, znj. Shpresa Miftari–Auditore e Performancës në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe njëkohësisht person i autorizuar i biznesit privat “4MS Consulting” sh.p.k., është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Miftari fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ajo ka telefonuar me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast, ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik.

Dorëheqjen e saj nga funksioni publik “Auditor i Performancës” e kemi vërtetuar edhe në bazë të Vendimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (DPK-Dpki-03-02-2708-15) të cilin znj. Miftari e ka dërguar në mënyrë elektronike (e-mail zyrtar) në Agjencinë kundër Korrupsionit, pas largimit nga funksioni publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

